



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**ZL.Anr. 835/2017**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Jehona Berisha, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal nga subjekti politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Kaçanik, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

**REFUZOHET** si i pabazuar apeli i parashtruar nga Jehona Berisha, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal nga subjekti politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Kaçanik, me shenjën ZL.Anr.835/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 09.11.2017 në ora 17:35, nga Jehona Berisha, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal nga subjekti politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Kaçanik, me të cilën pretendon se në fshatin Doganaj në Kaçanik, në Qendrat e Votimit QV nr. 0706D/2R, 0706d/03R, 0712D/02D dhe në, në vendvotime VV nr. 0706D/01R, 0706D/02R, 0706D/03R, 0707D/4D, 0709D/01D, 0719D/02D, 0720D/02D, 0705D/01R, 0704D/01R, ka konsideruar se ka manipulime duke theksuar se votat e saja nuk janë regjistruar në proces.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**Apeli është i pabazuar**

Paneli vlerëson se parashtruesja e apelit në apelin e parashtruar nuk e ka potencuar se sa vota i mungojnë në fshatin Doganaj në Kaçanik, në Qendrat e Votimit QV nr. 0706D/2R, 0706d/03R, 0712D/02D dhe në vendvotimet VV nr. 0706D/01R, 0706D/02R, 0706D/03R, 0707D/4D, 0709D/01D, 0719D/02D, 0720D/02D, 0705D/01R, 0704D/01R , si dhe në mbështetje të pretendimeve ankimore në apel nuk ka ofruar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimet në apel i parashtruar, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, ku është përcaktuar: “*se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”. Paneli gjatë vendosjes për një apel i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në apel dhe kur vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë të provuara me prova nga parashtruesi i apelit, siç është në rastin konkret, ku parashtruesi i apelit nuk e ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pretendimet e tij, e refuzon apelin si të pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**

Anr.835/2017 më datën 12.11.2017.



***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*